



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODER

DREJTORIA E PERGJITHSHME E MIREMBAJTJES SE OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Objekti i procedurës: “Mirëmbajtje e objekteve të trashëgimisë kulturore”

Kodi CPV: 50000000-5 – Shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje

Lloji i kontratës: Shërbime

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Fondi limit: 1 883 031,90 (Një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e një presje nëntëdhjetë) lekë pa TVSH

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Shkodër për vitin 2026, miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025

Afati i realizimit të kontratës: 2 (dy) javë

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor harton këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën me objekt “Mirëmbajtje e objekteve të trashëgimisë kulturore”.

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar në bazë të nevojave të përcaktuara nga njësia kërkuese, preventivit të hartuar dhe të miratuar, termave të referencës, grafikut të realizimit dhe analizës së natyrës së shërbimeve që do të kryhen. Përcaktimi i tyre është bërë duke pasur parasysh objektin, vlerën, kompleksitetin dhe afatin e realizimit të kontratës, si dhe nevojën për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për realizimin e saj.

Objekti i kontratës klasifikohet si shërbim, pasi qëllimi kryesor i prokurimit është realizimi i ndërhyrjeve të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të kushteve teknike dhe funksionale të objekteve të trashëgimisë kulturore. Furnizimi dhe vendosja e njërive të pompave të nxehtësisë përbën pjesë

të integruar të këtij shërbimi, duke përfshirë transportin, montimin, testimin dhe vënien në funksion të pajisjeve, në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Sipas preventivit, objekti përfshin, ndër të tjera, realizimin e hidroizolimit në sipërfaqe prej 46 m², si dhe furnizimin dhe vendosjen e dy njësive të jashtme të pompave të nxehtësisë me kapacitet 48 000 BTU dhe katër njësive me kapacitet 24 000 BTU, së bashku me ndërhyrjet e tjera të përcaktuara në preventiv.

Në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike është pasqyruar vlera prej 1 883 333,00 lekësh pa TVSH. Pas hartimit të preventivit dhe përllogaritjes së detajuar të fondit limit, bazuar në sasitë e përcaktuara dhe analizën e çmimeve për zërat përbërës të objektit të prokurimit, fondi limit i përllogaritur përfundimisht rezulton në vlerën 1 883 031,90 lekë pa TVSH.

Diferenca prej 301,10 lekësh ndërmjet vlerës së pasqyruar në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike dhe fondit limit të përllogaritur përfundimisht rrjedh nga përllogaritja e detajuar e fondit limit pas hartimit të preventivit dhe nuk lidhet me ndryshimin e objektit, sasive apo afatit të realizimit të kontratës. Për dokumentacionin e procedurës do të përdoret fondi limit i përllogaritur përfundimisht, në vlerën 1 883 031,90 lekë pa TVSH.

Në vijim, kriteret e veçanta të kualifikimit argumentohen në lidhje me natyrën dhe kërkesat konkrete të shërbimit, me qëllim verifikimin e kapacitetit ekonomik, financiar, teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës brenda kushteve dhe afatit të përcaktuar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit;
- b) Sigurimin e ofertës, sipas Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, me afatin e vlefshmërisë të përcaktuar në Dokumentet e Tenderit.

Argumentimi

Kërkesa për paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit përcaktohet në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe dispozitave përkatëse të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Formulari shërben si provë paraprake për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe për deklarimin e mungesës së shkaqeve të skualifikimit. Ofertuesi i renditur i pari paraqet dokumentet provuese për vetëdeklarimet e dhëna, përpara shpalljes fitues dhe fillimit të afateve të ankimit.

Kërkesa për sigurimin e ofertës përcaktohet në zbatim të nenit 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe dispozitave përkatëse të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021,

i ndryshuar. Duke qenë se procedura objekt i këtij procesverballi nuk është procedurë prokurimi me vlerë të vogël, kërkohet sigurimi i ofertës në përputhje me kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Kërkesa për sigurimin e ofertës synon të garantojë seriozitetin e ofertës dhe respektimin e detyrimeve të ofertuesve gjatë procedurës së prokurimit dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “E hapur e thjeshtuar” – shërbime.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, si dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në lidhje me nenin 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit shërben si provë paraprake për përmbushjen e kërkesave të kualifikimit dhe për mungesën e shkaqeve të skualifikimit. Nëpërmjet këtij formulari, operatori ekonomik deklaron, ndër të tjera, të dhënat lidhur me regjistrimin dhe statusin e tij, si dhe përmbushjen e kërkesave për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e kontratës.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet kërkohen sipas përcaktimeve të legjislacionit të prokurimit publik dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit, ndërsa Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikimet përkatëse gjatë zhvillimit të procedurës, kur e vlerëson të nevojshme.

Kjo kërkesë nuk vendos kërkesa shtesë dokumentare përtej Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Kërkesat konkrete që lidhen me licencimin profesional, të nevojshme për realizimin e ndërhyrjeve teknike të parashikuara në objektin e kontratës, përcaktohen dhe argumentohen veçmas në pikën 2.3.2 të këtij procesverballi.

Kërkesa është në përputhje me natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës dhe synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë aftësinë ligjore dhe profesionale për të ushtruar veprimtarinë që lidhet me shërbimet objekt prokurimi, duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku xhiroja për të paktën një vit të jetë jo më e vogël se 753 212,76 lekë pa TVSH.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik e arrin këtë vlerë në të paktën një (1) nga vitet financiare të kërkuara.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 43, pikat 1, 2, shkronja “c”, 3 dhe 6, dhe nenit 55, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për një nivel minimal të xhiros synon të verifikojë që operatori ekonomik disponon kapacitet të përshtatshëm ekonomik për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga realizimi i kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën, vlerën dhe kohëzgjatjen e shërbimit objekt prokurimi.

Vlera minimale e kërkuar është përcaktuar në masën 40% të fondit limit të procedurës dhe është vendosur në një nivel të arsyeshëm në raport me vlerën e kontratës. Kërkesa që kjo vlerë të realizohet në të paktën një nga vitet financiare 2023, 2024 ose 2025 shmanë detyrimin për një nivel të njëjtë xhiroje në çdo vit dhe u jep mundësi për pjesëmarrje operatorëve ekonomikë që kanë kapacitetin e nevojshëm, edhe nëse aktiviteti i tyre nuk ka qenë i njëjtë në të gjitha vitet.

Në këtë mënyrë, kriteri synon të sigurojë një nivel të përshtatshëm besueshmërie ekonomike për realizimin e kontratës, pa vendosur kërkesa më të larta se sa është e nevojshme në raport me objektin dhe vlerën e saj, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës efektive.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë shlyer detyrimet e maturuara për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026, për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit të pasqyruar në QKB, sipas afateve të pagesës të përcaktuara nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 76, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë përmbushjen e detyrimeve të maturuara për taksat dhe tarifat vendore nga operatori ekonomik, për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit të regjistruar në QKB. Përcaktimi i detyrimeve sipas afateve të pagesës të përcaktuara nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore siguron që operatorit ekonomik t’i kërkohej vetëm shlyerja e detyrimeve që kanë arritur afatin e pagesës dhe jo e kësteve apo detyrimeve që nuk janë ende të maturuara.

Kërkesa lidhet me verifikimin e respektimit të detyrimeve ligjore dhe fiskale vendore nga operatorët ekonomikë dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë. Dokumentacioni provues kërkohet në përputhje me mënyrën e përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, për të mundësuar verifikimin e deklarimit të operatorit ekonomik.

Kriteri është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e procedurës dhe nuk vendos kërkesa që tejkalojnë qëllimin e verifikimit të përmbushjes së detyrimeve vendore, duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa shërbimeve të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 20% e fondit limit, konkretisht **376 606,38 (treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtë presje tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**

Shërbime të ngjashme konsiderohen shërbimet e mirëmbajtjes dhe/ose riparimit të ndërtesave dhe objekteve, si dhe shërbime që përfshijnë ndërhyrje të ngjashme me ato të parashikuara në objektin e kësaj kontrate, përfshirë, sipas rastit, shërbime hidroizolimi dhe ndërhyrje në sistemet e kondicionimit dhe pajisjeve të ngjashme.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse vlera totale e shërbimeve të ngjashme të paraqitura arrin vlerën minimale të kërkuar, pavarësisht nëse është realizuar nëpërmjet një ose disa kontratave.

Për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

a) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik**, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të përcaktohen vlera, objekti dhe afati i përfundimit të kontratës, ose dokumentacion tjetër provues i parashikuar në Dokumentet Standarde të Tenderit;

b) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat**, dokumentacion provues, sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe legjislacionit në fuqi, nga i cili të evidentohen objekti, vlera dhe perioda e realizimit të shërbimeve.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të dispozitave përkatëse të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe të rekomandimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik për hartimin e kriterëve të kualifikimit.

Kërkesa për përvojë të ngjashme synon të verifikojë që operatori ekonomik ka eksperiencën e nevojshme për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duke marrë në konsideratë natyrën e ndërhyrjeve të parashikuara, të cilat përfshijnë mirëmbajtje dhe riparime të objekteve, ndërhyrje hidroizoluese, si dhe ndërhyrje në sistemet e kondicionimit.

Vlera minimale e kërkuar është përcaktuar në masën 20% të fondit limit dhe është vendosur në raport me madhësinë dhe kompleksitetin e kontratës. Mundësia e përmbushjes së kriterit nëpërmjet një ose disa kontratave u jep operatorëve ekonomikë mundësi të demonstrojnë përvojën e tyre të akumuluar në shërbime të ngjashme dhe shmang kufizimin e konkurrencës vetëm te operatorët që kanë realizuar një kontratë të vetme me vlerën e kërkuar.

Përkufizimi i shërbimeve të ngjashme është lidhur me natyrën dhe përmbajtjen e shërbimit objekt prokurimi dhe nuk kërkon që një kontratë e mëparshme të ketë pasur domosdoshmërisht të njëjtin objekt apo të njëjtën përbërje zërash. Kjo lejon vlerësimin e përvojës reale të operatorëve ekonomikë në shërbime që kanë karakteristika dhe kërkojnë aftësi teknike të krahasueshme me ato të kësaj kontrate.

Dokumentacioni i kërkuar synon të mundësojë verifikimin objektiv të përvojës së deklaruar, të vlerës, objektit dhe periudhës së realizimit të shërbimeve, duke u zbatuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Kriteri është në përpjesëtim me objektin dhe vlerën e kontratës dhe synon të sigurojë një nivel të arsyeshëm të kapacitetit teknik dhe profesional, pa vendosur kërkesa të panevojshme ose kufizuese për pjesëmarrjen në procedurë.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë profesionale të vlefshme, të lëshuar nga autoriteti kompetent, për realizimin e punimeve dhe ndërhyrjeve teknike të parashikuara në objektin e kontratës, në përputhje me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, të ndryshuar, me kategoritë e mëposhtme:

- **N.S.-4, niveli A** – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, për zërin e hidroizolimit të parashikuar në preventiv;
- **N.S.-12, niveli A** – Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit, për montimin dhe ndërhyrjet teknike në sistemet e kondicionimit dhe njësitë e pompave të nxehtësisë të parashikuara në preventiv.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të disponojë kategorinë e licencës që mbulon pjesën e punimeve që merr përsipër të realizojë, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, të dispozitave përkatëse të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Kërkesa për licencë profesionale është përcaktuar mbi bazën e zërave konkretë të preventivit dhe specifikimeve teknike dhe lidhet vetëm me ato ndërhyrje teknike për të cilat kërkohet realizim nga operatorë të pajisur me kategorinë përkatëse të licencës.

Në preventiv janë parashikuar zërat e mëposhtëm:

Kategoria e licencës	Zëri i preventivit	Vlera pa TVSH	Niveli
N.S.-4	Kodi 2.197 – “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama”, sasia 46 m ²	73 031,90 lekë	A
N.S.-12	“F.V. njësi e jashtme pompe nxehtësie 48 000 BTU”, sasia 2 komplete	830 000 lekë	A
N.S.-12	“F.V. njësi e jashtme pompe nxehtësie 24 000 BTU”, sasia 4 komplete	980 000 lekë	A

Zëri i hidroizolimit lidhet me kategorinë **N.S.-4**, e cila përfshin ndër të tjera punime mirëmbajtjeje dhe ristrukturimi, si dhe izolime të natyrave të ndryshme.

Zërat që lidhen me montimin dhe ndërhyrjet teknike në njësitë e pompave të nxehtësisë lidhen me kategorinë **N.S.-12**, e cila përfshin montimin, mirëmbajtjen dhe ristrukturimin e impianteve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit.

Vlera totale e zërave që lidhen me kategorinë **N.S.-12** është **1 810 000 lekë pa TVSH**, ndërsa vlera e zërit që lidhet me kategorinë **N.S.-4** është **73 031,90 lekë pa TVSH**. Këto vlera përbëjnë së bashku fondin limit të procedurës.

Përcaktimi i nivelit **A** për të dyja kategoritë është bërë në përputhje me klasifikimin e shoqërive ndërtimore sipas vlerave të punimeve për çdo kategori, ku niveli A mbulon vlera deri në 20 milionë lekë. Për rrjedhojë, vlerat e zërave të preventivit që lidhen me secilën kategori janë brenda kufirit të këtij niveli.

Parametrat e furnizimit me energji, tensionit dhe rrymës të përcaktuar në specifikimet teknike lidhen me karakteristikat teknike të pajisjeve dhe nuk përbëjnë zëra të veçantë për punime instalimi elektrik në preventiv. Për këtë arsye, nuk është kërkuar kategori tjetër licence përtej kategorive të lidhura drejtpërdrejt me zërat e mësipërm.

Kategoritë e licencave janë përcaktuar në mënyrë të lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe me ndërhyrjet teknike që do të realizohen gjatë zbatimit të kontratës, në përputhje edhe me kërkesën që kriteret e kapacitetit teknik të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa synon të garantojë që ndërhyrjet teknike të parashikuara në kontratë të realizohen nga operatorë ekonomikë që disponojnë licencat profesionale përkatëse, pa kërkuar kategori ose nivele licence që nuk lidhen me punimet konkrete të parashikuara në preventiv.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë, për periudhën e realizimit të kontratës, të paktën këtë personel teknik:

Nr.	Pozicioni	Numri
1	Inxhinier ndërtimi	1
2	Inxhinier mekanik	1

Inxhinieri i ndërtimit do të angazhohet për kontrollin teknik të ndërhyrjeve të hidroizolimit, ndërsa inxhinieri mekanik për kontrollin teknik të montimit, testimit dhe vënies në funksion të njërive të pompave të nxehtësisë.

Personeli mund të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik ose të vihet në dispozicion të tij për periudhën e realizimit të kontratës, nëpërmjet një forme të ligjshme disponimi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentet provuese si më poshtë:

- kopje të diplomës së arsimit të lartë që provon profilin përkatës;
- dokument që provon disponimin e personelit për periudhën e realizimit të kontratës, si kontratë individuale pune ose dokument tjetër i ligjshëm disponimi;
- për personelin që nuk është i punësuar pranë operatorit ekonomik, deklaratë disponueshmërie ose dokument tjetër që provon vënien në dispozicion të tij për realizimin e kontratës.

Dokumentet e paraqitura duhet të mundësojnë verifikimin e profilit profesional dhe të disponimit të personelit të deklaruar.

Argumentimi

Kërkesa për personelin teknik përcaktohet në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe dispozitave përkatëse të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

Kërkesa është përcaktuar në funksion të natyrës dhe përmbajtjes teknike të shërbimit. Objekti i kontratës përfshin ndërhyrje hidroizoluese dhe montimin, testimin dhe vënien në funksion të njërive të pompave të nxehtësisë, të cilat kërkojnë kontroll teknik nga profile të ndryshme profesionale.

Inxhinieri i ndërtimit lidhet me kontrollin teknik të ndërhyrjeve të hidroizolimit, ndërsa inxhinieri mekanik me kontrollin teknik të montimit, testimit dhe vënies në funksion të pajisjeve të pompave të nxehtësisë.

Dokumentet provuese kërkohen vetëm për të verifikuar dy elemente të kriterit: **profilin profesional dhe disponimin e personelit**. Nuk kërkohet dokumentacion shtesë që nuk lidhet drejtpërdrejt me këto dy elemente.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë, për periudhën e realizimit të kontratës, të paktën këtë personel zbatues:

Nr.	Profili	Numri
1	Mjeshtër hidroizolimi	1
2	Instalues i pajisjeve të kondicionimit	1

Personeli mund të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik ose të vihet në dispozicion të tij për periudhën e realizimit të kontratës, nëpërmjet një forme të ligjshme disponimi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentet provuese si më poshtë:

- dokument që provon disponimin e personelit për periudhën e realizimit të kontratës, si kontratë individuale pune ose dokument tjetër i ligjshëm disponimi;
- për personelin që nuk është i punësuar pranë operatorit ekonomik, deklaratë disponueshmërie ose dokument tjetër që provon vënien në dispozicion të tij;
- dokument që provon kualifikimin profesional për profilin e deklaruar, kur një dokument i tillë kërkohet nga legjislacioni përkatës ose kur është lëshuar për profilin e deklaruar.

Dokumentet duhet të mundësojnë verifikimin e profilit të personelit dhe të disponimit të tij për realizimin e kontratës.

Në rastin e operatorëve ekonomikë që paraqiten në bashkëpunim, kriteri mund të përmbushet nga një ose më shumë anëtarë, në përputhje me pjesën e punëve që secili prej tyre merr përsipër të realizojë.

Argumentimi

Kërkesa për personelin zbatues përcaktohet në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe dispozitave përkatëse të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

Kërkesa është përcaktuar mbi bazën e preventivit, specifikimeve teknike dhe grafikut të realizimit të shërbimit. Objekti i kontratës përfshin ndërhyrje hidroizoluese në një sipërfaqe prej 46 m² dhe montimin e 6 njësive të pompave të nxehtësisë.

Mjeshtri i hidroizolimit dhe instaluesi i pajisjeve të kondicionimit janë kërkuar si profile të ndryshme zbatimi, për shkak të natyrës së ndryshme të ndërhyrjeve që do të realizohen. Personeli

i këtij kriteri është i ndryshëm nga personeli teknik i përcaktuar në kriterin 2.3.3, pasi ka rol në realizimin praktik të shërbimit.

Dokumentet provuese kufizohen në ato të nevojshme për të verifikuar disponimin dhe, kur është e aplikueshme, kualifikimin profesional të personelit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë, në pronësi, me qira ose nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme disponimi, të paktën:

- **1 (një) automjet transporti mallrash, tip furgon ose mjet ekuivalent, me karrocieri të mbyllur ose të mbuluar dhe me kapacitet mbajtës jo më pak se 1 (një) ton.**

Mjeti duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e njësive të pompave të nxehtësisë, materialeve hidroizoluese dhe materialeve e pajisjeve të tjera të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet, sipas përcaktimeve të DST dhe legjislacionit në fuqi, dokumentet provuese për disponimin e mjetit, si më poshtë:

- për mjetin në pronësi: **lejen e qarkullimit** dhe dokumentacionin e vlefshëm të mjetit, përfshirë **certifikatën e kontrollit teknik, kur është e aplikueshme, dhe policën e sigurimit të detyrueshëm;**
- për mjetin e marrë me qira ose në përdorim: **kontratën e qirasë ose dokumentin tjetër që provon të drejtën e ligjshme të përdorimit**, së bashku me dokumentacionin e mjetit.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të mundësojë verifikimin e karakteristikave të kërkuara për mjetin, përfshirë kapacitetin mbajtës jo më pak se 1 ton dhe karrocierin e mbyllur ose të mbuluar.

Argumentimi

Kriteri përcaktohet në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 41, pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar. Kërkesa për mjete dhe pajisje teknike lidhet me nevojën për të siguruar kapacitetet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës dhe duhet të jetë e lidhur me objektin dhe në përpjesëtim me të.

Kërkesa është përcaktuar duke iu referuar preventivit, specifikimeve teknike dhe mënyrës së realizimit të shërbimit. Gjatë zbatimit të kontratës parashikohet transporti i njësive të pompave të nxehtësisë, materialeve hidroizoluese dhe materialeve të tjera ndihmëse të nevojshme për kryerjen e ndërhyrjeve të parashikuara.

Sipas specifikimeve teknike, kontrata përfshin:

- 2 (dy) njësi të jashtme pompe nxehtësie me kapacitet 48 000 BTU, me peshë neto 101 kg secila;
- 4 (katër) njësi të jashtme pompe nxehtësie me kapacitet 24 000 BTU, me peshë neto 45 kg secila;
- materiale hidroizoluese për një sipërfaqe prej 46 m².

Pesha totale neto e gjashtë njësive të pompave të nxehtësisë është rreth 382 kg. Duke marrë në konsideratë edhe materialet hidroizoluese, ambalazhimin dhe materialet ndihmëse që nevojiten gjatë realizimit të shërbimit, kërkesa për një mjet me kapacitet mbajtës jo më pak se 1 ton synon të sigurojë kapacitet të mjaftueshëm transporti dhe transport të përshtatshëm e të sigurt të pajisjeve dhe materialeve objekt kontrate.

Kërkesa për karrocë të mbyllur ose të mbuluar lidhet me nevojën për mbrojtjen e njësive të pompave të nxehtësisë dhe materialeve gjatë transportit nga dëmtimet mekanike dhe nga kushtet atmosferike.

Nuk kërkohet mjet vetëshkarkues apo mjet i rëndë, pasi objekti i kontratës nuk përfshin transportin e sasive të mëdha të materialeve inerte, punime gërmimi, prishje apo largim të sasive të mëdha të mbetjeve.

Lejimi i mjetit në pronësi, me qira ose nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme disponimi krijon mundësi të barabarta pjesëmarrjeje dhe shmang kufizimin e operatorëve ekonomikë vetëm te mjetet në pronësi.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me realizimin e kontratës dhe synon të sigurojë kapacitetin minimal të nevojshëm për transportin e pajisjeve dhe materialeve objekt kontrate, në përputhje me natyrën, vlerën dhe afatin e shërbimit.

II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar në mbështetje të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ato janë përgatitur mbi bazën e nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor, preventivit të hartuar dhe të miratuar, termave të referencës, grafikut të realizimit dhe natyrës së ndërhyrjeve që do të kryhen në objektet e trashëgimisë kulturore.

Qëllimi i shërbimit është mirëmbajtja dhe përmirësimi i kushteve teknike dhe funksionale të objekteve, nëpërmjet realizimit të ndërhyrjeve të parashikuara në preventiv, përfshirë furnizimin, vendosjen dhe vënien në funksion të pajisjeve të nevojshme për realizimin e shërbimit.

Në mënyrë konkrete, objekti i shërbimit përfshin:

Përshkrimi i shërbimit	Sasia	Vlera pa TVSH
Hidroizolim me emulsion bitumi dhe dy shtresa katrama, sipas zërit 2.197 të preventivit	46 m ²	73 031,90 lekë
Furnizim dhe vendosje e njësive të jashtme të pompave të nxehtësisë 48 000 BTU	2 komplete	830 000 lekë
Furnizim dhe vendosje e njësive të jashtme të pompave të nxehtësisë 24 000 BTU	4 komplete	980 000 lekë

Specifikimet teknike përcaktojnë kërkesat minimale të nevojshme për cilësinë, karakteristikat teknike, funksionalitetin, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe mënyrën e realizimit të shërbimit.

Për ndërhyrjet e hidroizolimit janë përcaktuar kërkesat për përgatitjen e sipërfaqes, përdorimin e emulsionit bituminoz dhe vendosjen e dy shtresave të katramasë, si dhe karakteristikat teknike të materialeve që do të përdoren, në përputhje me specifikimet teknike dhe preventivin.

Për njësitë e pompave të nxehtësisë janë përcaktuar parametrat minimalë të kapacitetit, performancës, furnizimit me energji, sigurisë dhe funksionimit, si dhe kërkesat për furnizimin, vendosjen, testimin dhe vënien në funksion të tyre. Pajisjet duhet të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe të përmbushin karakteristikat minimale të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesat teknike janë përcaktuar duke u bazuar në funksionin që duhet të përmbushin materialet dhe pajisjet, kushtet e përdorimit, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe rezultatin teknik të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Parametrat e përcaktuar janë kërkesa minimale dhe nuk synojnë një produkt, prodhues apo burim të caktuar.

Shërbimi do të realizohet në përputhje me preventivin, specifikimet teknike, termat e referencës dhe grafikun e realizimit prej 2 (dy) javësh, si dhe me standardet dhe rregullat teknike të zbatueshme për ndërhyrjet përkatëse. Në rast të referimit në ndonjë standard, specifikim teknik, markë, patentë, tip, origjinë ose burim të caktuar, referimi do të kuptohet si “ose ekuivalent”, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Përputhshmëria e zgjidhjeve teknike të ofruara me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit do të verifikohet mbi bazën e dokumentacionit teknik të kërkuar në DST dhe, sipas rastit, nëpërmjet katalogëve, fletëve teknike, dokumenteve të prodhuesit ose dëshmimeve të tjera të përcaktuara në dokumentet e procedurës. Kërkesat për dokumentacion teknik do të zbatohen vetëm në masën e nevojshme për verifikimin e parametrave të përcaktuar.

Pranimi i shërbimit do të bëhet pas verifikimit të realizimit të ndërhyrjeve sipas preventivit dhe specifikimeve teknike, përfshirë kontrollin e cilësisë së hidroizolimit dhe testimin funksional të pajisjeve të instaluar.

Në hartimin e specifikimeve teknike nuk janë përdorur, si rregull, marka tregtare, emërtime prodhuesish, patenta, origjinë apo burime specifike që mund të favorizojnë ose përjashtojnë

operatorë ekonomike të caktuar. Kërkesat janë përcaktuar mbi bazën e karakteristikave funksionale dhe teknike minimale të nevojshme për realizimin e shërbimit.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike janë të lidhura drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe me nevojat konkrete të kontratës. Ato përcaktojnë kërkesat minimale të nevojshme për realizimin cilësor të shërbimit dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Në hartimin e specifikimeve teknike është synuar respektimi i parimeve të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive, duke shmangur kërkesat që mund të krijojnë pengesa të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.